

VENDIM
Nr.233, datë 25.4.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS
NGA KTHESA E REPARTIT USHTARAK DERI TEK IMPIANTI I BOVILLËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës nga kthesa e repartit ushtarak deri tek impianti i Bovillës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ndërmarrjes së Ujësjetllës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 12 488 m² tokë/arë, e vlerësuar me 700 lekë/m², në shumën e përgjithshme 1 741 600 (një milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 179 000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Ndërmarrja e Ujësjetllës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 1 741 600 (një milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale, për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit maj 2007.

7. Ndërmarrja e Ujësjetllës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë, të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të përcaktuar në pikën 6, ndërsa për pronarët, për të cilët në kolonën e fundit të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë deri në çastin, që pronarët të paraqesin dokumentacionin e pronësisë, pranë Ndërmarrjes së Ujësjetllës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ndërmarrja e Ujësjetllës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
RRUGËS NGA KTHESA E REPARTIT USHTARAK DERI NË IMPIANTIN E BOVILLËS**

Nr.	Emri	Sipërfaqja tokë/arë	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Shënime
1.	Astrit Hoxha	40 m ²	700	28 000	Plotësim dokumentacioni
2.	Hasan Livadhi	458 m ²	700	320 600	Plotësim dokumentacioni
3.	Skënder Livadhi	640 m ²	700	448 000	Plotësim dokumentacioni
4.	Gani Lozi	330 m ²	700	231 000	Plotësim dokumentacioni
5.	Gëzim Livadhi	1020 m ²	700	714 000	Plotësim dokumentacioni
	Shuma	2 488		1741600	

Vlera totale e këtij shpronësimi është 1 741 600 lekë (një milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind) lekë.

